

VENDIM
Nr. 755, datë 26.10.2016

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 710, DATË 21.8.2013,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
SISTEMEVE TË RUAJTJES SË INFORMACIONIT, VAZHDUESHMËRISË SË PUNËS
DHE MARRËVESHJEVE TË NIVELIT TË SHËRBIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10 325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, dhe të nenit 21, të ligjit nr. 10 273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 710, datë 21.8.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

1. Paragrafi i dytë, i pikës 1, ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“Institucioni, gjatë projektimit të këtyre sistemeve, duhet të parashikojë që nyja primare të hostohet pranë Qendrës së të Dhënave Qeveritare dhe nyja sekondare të hostohet pranë Qendrës së Vazhdueshmërisë së Punës (*Business Continuity Center*).”.

2. Në pikën 3, të vendimit, pas fjalëve “...Qendra e të Dhënave Qeveritare...”, shtohen fjalët “...ose Qendra e Vazhdueshmërisë së Punës...”.

3. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të marrë masat për ngritjen dhe zhvillimin e Qendrës së Vazhdueshmërisë së Punës, duke filluar nga data 1 nëntor 2016.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Niko Peleshi